



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT (GLLOGOC)



Zyra e Kuvendit të Komunës

nr. 12-513-5137 dt. 08.04.2013

Duke u bazuar ne nenin 12 dhe 40 të ligjit nr.03/L-40 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nenit 40 të Ligjit nr. 2004/18, për tregtinë e mbrendshme dhe Udhëzimit administrativ nr. 2007/03, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizimit të tregtisë, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur më dt.29.03.2013 aprovoi:

RREGULLORËN

PËR

FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ORGANIZATAVE TË BIZNESIT NË KOMUNËN E DRENASIT

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëminë e tregtisë dhe të aktivitetëve tjera: hoteleri, zejтари, shërbime dhe aktivitete tjera të organizimit në territorin e Komunës së Drenasit.

Neni 2

Organizatave e biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregullorëje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

- 3.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.
3.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

II.ORARI I PUNËS

Neni 4

Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjës verore dhe dimrore, në interval kohorë:

- a. **Periudha verore fillon me 1 prill dhe mbaron me 30 shtator të vitit;**
- b. **Periudha dimërore fillon me 1 tetor dhe mbaron me 31 mars të vitit.**

Neni 5

- 5.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në dyqanët zejtare:
- a. **periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 19:00.**
- 5.2. Bukëpjeksit, gjellëtoreset dhe qebaptoreset punojnë qdo ditë pune:
- a. **periudha verore, prej orës 6:00 deri në orën 23:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 7:00 deri në orën 22:00.**
- 5.3. Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveq: bukëpjekësve, gjelltorëve, çebaptoreset, salloneve të ondulimit, floktarëve, kozmetikave, autolarjëve dhe pikave të shitjes së shtypit ditorë.

Neni 6

- 6.1. Orari punës në vetëshërbime, supermarkete dhe dyqane ushqimore, do të jetë:
- a. **periudha verore, prej orës 7:00 deri në orën 24:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 22:00.**
- 6.2 Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanët e këpucëve, dyqanët e paisjeve teknike shtëpiake teknikës së bardhë dhe veprimtarine të tjera jo ushqimore, do të jetë:
- a. **periudha verore, prej orës 7:00 deri në orën 21:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00.**
- 6.3. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni, do të ket në ditën e fundjavës (të dielën) dhe ditët e festave, ku orari i punës do të fillojë në orën 8:00 dhe do të mbarojë në orën 12:00.
- Vetshërbimet dhe supermarketet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Qytetin e Drenasit dhe në Bushat mund të kujdestarojnë të Dielave sipas Marrveshjes së hartuar dhe nënshkruar në mes tyre në koordinim dhe aprovim të DBZHE.
- 6.4. Organizatat e biznesit, sipas pikës 1 të këtij neni, që veprojnë në periferi të qytetit, në ditën e fundjavës (të dielën), mund të punojnë me orar të zgjatur edhe pas orës 11.00, me pëlqim të veçant të lëshuar nga Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Drenas.

Neni 7

- 7.1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depotë e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merrën me prodhimin e betonit, do të jetë:

- a. **periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 18:00.**
- 7.2. Ditën e fundëjavës (të dilen) dhe gjatë ditëve të festave, depotë nuk punojnë.
- 7.3. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ultë dhe i lartë), do të jetë:
- a. **periudha verore, prej orës 7:00 deri në orën 18:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 17:00.**
- 7.4. Ndërmarrjet ndërtimore në rastet të jashtë zakonshme, për rshkak të natyrës së punëve, me leje të posaqme, të cilën e lëshon Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik, mundë të punojnë me orar të zgjatur deri ne ora 23:00.

Neni 8

- 8.1. Orari i punës në Restorante, kafene, ëmbëltore e tj. të ngjajshme do të jetë:
- a. **periudha verore, prej orës 7:00 deri në orën 24:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës :7.00 deri në orën 23:00.**
- 8.2. Orari i punës në hotele dhe motele është i njëjtë në të dy sezonat dhe fillon prej orës 06 deri 24.00.
- 8.3. Përjashtim nga pika 1 dhe 2 e këtij neni do të ketë, sepse mundë të punojnë më gjatë se orari i parapare i punës, por jo më shumë se deri në ora 3.00 të mengjesit. Për këtë duhet të kërkohej leje e veçantë, të cilën e lëshon Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 10 € për orë pune.
- 8.4. Veprimtarive të lartëpërmendura ne pikën 1 të këtij neni nuk ju lejohet shërbimi për musafir jashtë objektit pas orës 24:00.

Neni 9

- 9.1. Orari i punës në kafe-bar dhe diskoklube, është e njëjte për të dy sezonat, fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 3:00 (të mengjesit).
- 9.2. Orari i punës për klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonat, fillon prej orës 23.00 dhe mbaron në oren 5.00 (mengjesit).
- 9.3. Orari i punës për internet-kafe dhe bastore fillon në ora 8:00 dhe mbaron në ora 23:00.

Neni 10

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive punojnë pa kufizime.

Neni 11

Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj rregullorëje gjatë orarit të punës nuk iu lejohet t'u prishet qetsia e qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohët veprimtaria.

Neni 12

- 12.1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:
- a. **periudha verore, prej orës 6:00 deri në orën 19:00;**
 - b. **periudha dimërore, prej orës 7:00 deri në orën 18:00.**

12.2. Tregu i gjelbërt nuk do të punojë gjatë ditës së fundjavës (të dielën) dhe ditëve të festave.

12.3. Tregu javorë i kafshëve punon të Ejtën(në Drenas) dhe të Shtunën(në Bushat).

Neni 13

Në objektet hoteliere të cilat gjenden në afërsi deri në 100 metra nga objektet e banimit, në të cilat organizohen programe muzikore të gjallë apo me audio-video mjete për reproduktimin e zërit, programi nuk mund të vazhdojë pas orës 24:00.

Neni 14

Orari i punës në pikat e shitjes së karborantëve është i njëjtë në të dy sezonat, fillon prej orës 00:00 dhe zgjatë deri në orën 24.00 (pa ndërprerë).

Neni 15

15.1. Orari i punës në barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë:

a. periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00;

b. periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00.

15.2. Në raste urgjente të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mundë të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë sipas paragrafit 15.1.

15.3. Barnatorët që veprojnë në qytet në afërsi të shërbimeve mjeksore, në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëpunim me DSHMS dhe Drejtoratin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik do të kujdestarojnë 24 orë pa ndërprerë.

Neni 16

16.1. Organizatat e biznesit mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave të parapara me ligj për festat zyrtare deri në ora 1:00 (të mëngjesit).

16.2. Për të gjitha rastet e parapar në pikën 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

III.DISPOZITAT NDESHKUSE

Neni 17

Të gjitha organizatat e biznesit do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 4, 5,6,7,8,9,10,11,13,14 dhe 15 të kësaj rregullorje, si më poshtë:

- a. Përsonat juridikë.....200 – 400 €;**
b. Përsonat fizikë.....100 – 200 €.

Neni 18

Të gjitha organizatat e biznesit të cilat marrin leje për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afaristë dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve do tu merrët pëlqimi për ushtrimin e veprimtarisë së lëshuar nga DBZHE.

IV.DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 19

Për zbatimin e kësaj Rregullorëje do të kujdesët Drejtorati i Inspeksionit dhe Policia e Kosovës .

Neni 20

Të gjitha organizatat e biznesit janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregullorëje, në afatin 30 ditësh nga dita e hyrjes së kësaj rregullorëje në fuqi.

Neni 21

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorëje, shfuqizohet Rregullorëja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës 01 nr. 330-5638 e dt.31.07.2008.

Neni 22

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Bazaj

